



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2021:250738

Datë: 24.12.2024

Numri i dokumentit: 06648167

C.nr.920/2021

GJYKATA THEMELORE GJILAN- DEGA VITI, gjyqtari Alush Sinani, me bashkëpunëtoren profesionale Lumturije Fetahu Xhelili, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.H. dhe R.H., që të dytë nga fshati B., Komuna e Vitisë, të cilët i përfaqëson me autorizim S.S., avokat me seli të zyrës në Viti, kundër të paditurëve S.D. dhe S.L. që të dytë ish nga Vitia, tani me vendbanim të panjohur, të cilëve, gjykata iu ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm T.A., avokat me seli të zyrës në Viti, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit 9,750.00 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe publik më datë 18.12.2024, mori, ndërsa me datën 23.12.2024, perpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I. Miratohet kërkesëpadia e paditësëve A.H. dhe R.H., kundër të paditurave, S.D. dhe S.L. **VËRTETOHET** se paditësit, në bazë të mbajtjes me mirëbesim, jan pronar;

a. të ngastrës me numër 0542-2, në vendin e quajtur “ Jezava Blato”, me sipërfaqe prej 3722m², ZK Viti, e evidentuar në emër të S.D., e cila kufizohet me në anën veriore me parcelën numër 351-0, me gjatësi 34.76m, në anën lindore kufizohet me parcelën numër 487-0, 492-0 dhe 493-0 me gjatësi 109.05m, në anën jugore kufizohet me parcelen numer 541-0 me gjatësi 35.55m dhe në anën perendimore kufizohet me parcelën numër 542-1, me gjatësi 108.47m.

b. të ngastrës me numër 0542-1, në vendin e quajtur “Jezava Blato”, me sipërfaqe prej 3723m², ZK Viti, e evidentuar në emër të S.L. e cila kufizohet me në anën veriore me parcelën numër 351-0, me gjatësi 34.76m, në anën lindore kufizohet me parcelën numër 542-0 me gjatësi 108.47m, në anën jugore kufizohet me parcelen numer 541-0 me gjatësi 34.27m dhe në anën perendimore kufizohet me parcelën numër 3604-0, gjegjësishtë me lumin “Morava e Binçës”, me gjatësi 108.56m, dhe

II. DETYROHEN të paditurat S.D. dhe S.L. ish nga Vitia, t’ia njohin të drejtën e pronësisë paditësve paditësve A.H. dhe R.H., dhe të durojnë që ngastrat e lartpërmendur të regjistrohet në emrin e paditësve.

III. Ky aktgjykim për Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë, paraqet bazë, që në regjistrat kadastralë, të bëhet ndryshimi.

II. Shpenzimet e procedurës do t'i heqin paditësit.

Arsyetim

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit, më datë, 08.11.2021 në këtë gjykatë, përmes përfaqësuesit të tyre të përbashkët me autorizim, kanë paraqitur padi kundër të paditurëve S.D. dhe S.L.ish nga Viti, me objekt kontesti vërtetimin e pronësisë në bazë të mbajtjes me mirëbesim, me pretendimin se me datën 12.12.1987, paditësi A.H., nga i padituri S.D., ka blerë ngastren me numër P-70101007-00542-2, në vendin e quajtur “Jezava Blato”, me sipërfaqe prej 3722 m², ZK - Viti, dhe ngastren me numër P-70101007-00542-1, në vendin e quajtur “Jezava Blato”, me sipërfaqe prej 3722 m², ZK – Viti, nga i padituri S.L., kishin përpiluar kontrata private dhe me nënshkrimin e kësaj kontarte shitësit iu kanë paguar në tërësi çmimin e shitblerjes dhe atë shumën prej 3 milion idinar jugosllav, ku sipas marrëveshjes prezencë kishin qenë edhe dëshmitarët R.M dhe R.D.dhe që nga atëherë tani paditësit kanë qenë në posedim të lirë dhe të pa penguar nga askush të këtyre paluajtshmërive, pronat e lartëcekura ishin shitur në mënyrë të rregullt dhe me pelqimin e dy palëve shitësit dhe blerësit, blerësi kishte kryer obligimet ndaj shitësve, dhe shitësit ia kanë dorëzuar në posedim blerësit palujtëshmerit në fjalë. Mirëpo për arsyeje të neglizhencës së palëve, por edhe të organeve kompetente pronat e njejta ende janë bartur në emrin e të paditurëve.

Meqenëse palëve të paditura, nuk është arritur që t'i dorëzohet padia në mënyrë të rregullt, pasi në adresën ekzistuese sipas shkresave të lëndës-fletëkthesës, rezulton se adresa e tyre është e panjohur, gjykata ka kërkuar nga Stacioni Policor në Viti, sigurimin e adresës dhe vendbanimit të tyre.

Pasi që nga ana e Policisë së Kosovës, nuk ka qenë e mundur të sigurohet adresa e të paditurëve me kërkesën të paditësve, gjykata, të paditurëve, në pajtim me nenin 79 pika 3 dhe 81 të LPK-së, i ka caktuar përfaqësues të përkohshëm nga radha e avokatëve, për të mbrojtur të drejtat e tyre, vendim ky i cili është publikuar në tabelën e shpalljeve të gjykatës dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, konform nenit 83 të LPK-së.

Paditësit përmes përfaqësuesit të tyre të përbashkët me autorizim, Av. S.S., pretendimet i ka përsëritur edhe në shqyrtimin përgatitor, kryesor dhe në fjalën përfundimtare, duke theksuar se pas administrimit të provave materiale dhe personale, është vërtetuar se paluajtshmërinë e cila është objekt kontesti, paditësit e kanë blerë me datën 12.12.1987, e kanë përmbushur në tërësi çmimin e kontraktuar dhe se nga ajo kohë kanë qenë në posedim të vazhdueshëm dhe të papenguar të këtyre paluajtshmërive, duke konsideruar se ky posedim është me mirëbesim dhe janë plotësuar kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së pronësisë në bazë të mbajtjes me mirëbesim. Ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësëve ta miratoj dhe të vërtetoj se janë pronar, të vetëm i këtyre ngastrave kadastrale.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurëve, në përgjigje në padi ka kundërshtuar në teresi kërkesëpadinë e paditësve, sepse padia është e paargumentuar dhe e pa mbështetur në prova

konkrete, ndërsa në seancën, kryesore në fjalën përfundimtare, ka theksuar se pas administrimit të provave, degjimin e dëshmitareve, i mbetet gjykates që në pajtim me ligjin dhe provave të adminstruara të vendos sipas bindjes së saj. Nuk i ka kundërshtuar propozimet për administrimin e provave materiale, nuk ka pasur vërejtje në asnjë provë materiale e as deklaratat e dëshmitarëve. Gjithashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës sipas OAK-së.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë pretendimet e palëve ndërgjyqëse si dhe për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike, gjykata i ka administruar dhe vlerësuar këto prova: -Certifikata pronës me nr. 1450/2024 e datës 15.10.2024, për ngastrën kadastrale 00542-1 ZK.Viti bashke me kopjen e planit me të njëjtin nr. dhe datë, Certifikata pronës me nr. 1450/2024 e datës 15.10.2024, për ngastrën kadastrale 00542-2 ZK.Viti bashke me kopjen e planit me të njëjtin nr. dhe datë, Kontrata private e shitblerjes e dates 12.12.1987, Kërkesa për verifikimin e pronës drejtuar Agjencisë kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës bashke me përgjigjen e datës 01.08.2024 me nr.te references 01007/24/hjg, Kërkesa – përgjigja nga S.P Viti e dates 10.10.2024 për verifikim e vendbanimit për të paditurat S.D., S.L. ish nga Vitia, Procesverbali i datës 22.11.2024, i hartuar në vendngjarje, Ekspertiza e ekspertit gjeodet e dorëzuar në gjykatë me datë 05.12.2024, e përpiluar nga eksperti Feat Shaqiri-gjeodet i licencuar në Viti, Deklarata e D.R.e dhene nën betim tek zyra e noterit A.S.në Viti, me numer LRP .nr. 8785/2024 e dates 07.11.2024, dhe ka dëgjuar në cilësi të palës paditëse A.H.dhe ka dëgjuar dëshmitarin A.H. nga fshati B., Komuna e Vitisë.

Seanca e vendshiqimit

Më datë 22.11.2024, gjykata e ka mbajtur seancën e vend-shikimit, në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesi i paditësve, përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurëve Av.T.A.dhe eksperti gjeodet F.S.ngastrat kadastrale kontestuese, në terren shfrytëzohen, aktualisht janë të punëshme dhe për momentin një pjesë e tyre është e mbellur me kulturë bujqësore grurë dhe pjesa tjetër ka qenë e mbjellur me kulturë të misrit, e njëjta kufizohet dhe atë, parcela e me numër 542-2, në sipërfaqe prej 3722m², në anën lindore kufizohet me parcelën numër 487-0, 492-2, 493-0, në pjesën jugore me parcelën 541-0, dhe në pjesën perendimore me parcelën 542-1, dhe në anën veriore me parcelën 351-0, ngastar me numër 542-1, kufizohet në anën lindore me parcelen 542-2, në anën jugore me parcelën 541-0, në anën perendimore kufizohet me lumin Morava p.sh. dhe në anën veriore me parcelën 351-0.

Përfaqësuesi i përkohshëm nuk ka pasur vërejtje.

Konstatimi i ekspertit gjeodet

Në konstatimin e tij, eksperti gjeodet, ka gjetur : se parcela me numër 0542-1, në vendin e quajtur “Jezava Blato”, me sipërfaqe prej 3723m², ZK Viti., me kulturë bujqësore arë e klasës 1, e evidentuar në emër të S.L.e cila kufizohet me në anën veriore me parcelën numër 351-0, me gjatësi 34.76m, në anën lindore kufizohet me parcelën numër 542-0 me gjatësi 108.47m, në anën jugore kufizohet me parcelen numer 541-0 me gjatësi 34.27m dhe në anën perendimore

kufizohet me parcelën numër 3604-0, gjegjësishtë me lumin “Morava e Binçës”, me gjatësi 108.56m dhe parcela me numër 0542-2, në vendin e quajtur “ Jezava Blato”, me sipërfaqe prej 3722m², ZK Viti, me kulturë bujqësore arë e klasës 1, e evidentuar në emër të S.D., e cila kufizohet me në anën veriore me parcelën numër 351-0, me gjatësi 34.76m, në anën lindore kufizohet me parcelën numër 487-0, 492-0 dhe 493-0 me gjatësi 109.05m, në anën jugore kufizohet me parcelen numer 541-0 me gjatësi 35.55m dhe në anën perendimore kufizohet me parcelën numër 542-1, me gjatësi 108.47m, parcelat në fjalë janë të punuara dhe për momentin një pjesë e tyre është e mbjellur me kulturë bujqësore grurë dhe pjesa tjetër është me mbetje të misrit, gjithashtu të rrethuara me parcelat eë punuara, parcela nr.542-1, në anën perendimore kufizohet me bregun e lumit “Morava e Binçës”, i cili ka përfshirë një sipërfaqe të konsiderueshme të parcelës në fjalë.

Përmbledhje e deklaratave të dëshmitarëve

Paditësi, A. H. , i dëgjuar në cilësi të palës në seancën e datës 18.12.2024, ka deklaruar se me L. dhe D. i kishte njoftuar permes M. R. me të cilen ka pasur një are në mexhë me te, ai e kishte njoftuar se keto dy motra, pra L. dhe D. ishin duke i shitur arat ne vendin e quajtur “Jezava Bllato” afer arave të tij (paditëdsit) qe i kishte pasur me parë, kjo ka ndodhur ne vitin 1987, i kishte thënë Milloradit se është i interesuar me i ble ato ara dhe kan caktuar ditën me u taku me dy pronaret motrat, Desanken dhe Leposaven, ishin takuar në shtëpinë e M. në Viti dhe aty ishin marrë vesh për cmimin dhe pagesën e arave, po ashtu ate ditë kishin lidhur edhe nje kontratë private me datë 12.12.1987, në të cilën kishin qenë prezente dy motrat S.D. dhe S.L. si dhe dy dëshmitar, M.R.dhe djali i tij D.R., pazari i ketyre dy arave kishte qenë ne vlere te atehershme prej 3 milion dinar jugosllav dhe te njejten shumë në tersi ja kishte paguar po te njejten ditë, menjehere ia kishin dhënë fletat poseduese dhe e kishte marrë në posedim, në pranverë të vitit tjetër ka filluar me i punuar me mbjellje bujqesore, prej atehere e deri me e sot e punon pa nderprere. Kurr nuk është penguar nga askush gjate punimit të ketyre dy arave, prej atehere e deri më tani. Për M.R.ka degjuar se ka vdekur, ndersa djali i tij D. i cili jeton dhe punon ne Beograd ka qenë nje vikend dhe ka dhene deklaratë nënbetim tek zyra e noterit A.S.ne Viti, me nume LRP .nr. 8785/2024 e dates 07.11.2024, paditësi ka deklaruar se në kohen kur e i ka blerë, ka qenë e ndaluar me ligj te Kuvendit te Republikës së Serbisë shitblerja e palujtshmerive dhe bartja e pronave te serbëve në emer te shqiptarve, kjo ka qenë për shkak te nje programi politik te Serbisë për ndalimin e shpernguljes se serbëve nga Kosova

Dëshmitari A.H., në seancën e shqyrtimit kryesor, ndër të tjera, ka deklaruar se: e din se arat të cilat janë në kontest A. i ka blerë, sa i kujtohet ka qenë viti 1987, nga dy motra emrat e te cilave nuk i kujtohen, por prezent kur i kishte blerë kishte qenë M.R.dhe djali i tij D.R., pasi i kishte berë pazar i kishte paguar dhe që atehere e deri me sot ato ara i ka punuar Akia e shpesh here edhe unë (dëshmitari) dhe asnjehere nuk ka degjuar qe dikush e ka penguar Akiun. Keto dy ara gjenden në Jezavë në anen e majte te rruges Viti- Kllokot, pas një fushe te sportit e mbuluar me shator dhe te njejtat ara prekin ne kanall, ne stomin e lumit Morava.

Provat materiale

-Sipas certifikatës me numër certifikatat me numër 1450/2024, e datës 15.10.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se parcela me numër 00542-1, në vendin e quajtur “Jezava Blato”, me kulturë “Bujqësore Arë kl, 1” me sipërfaqe prej 3723 m², ZK Viti, evidentohet në emër të S.L.. Në kopjen e planit, të datës 15.10.2024, në formë skice është paraqitur parcela 00542-1, me shënime për sipërfaqet e saj.

-Sipas certifikatës me numër certifikatat me numër 1450/2024, e datës 15.10.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se parcela me numër 00542-2, në vendin e quajtur “Jezava Blato”, me kulturë “Bujqësore Arë kl, 1” me sipërfaqe prej 3722 m², ZK Viti, evidentohet në emër të S.D.. Në kopjen e planit, të datës 15.10.2024, në formë skice është paraqitur parcela 00542-2, me shënime për sipërfaqet e saj.

-Sipas përgjigjjes së Stacionit policor në Viti datës 10.10.2024, gjykata është informuar se të paditurat të paditurëve S.D. nuk jetonë në Viti, por e njejtit jetonë në shtetin e Serbisë dhe se nuk i dihet adresa e sakt, ndërsa e paditura S.L. nuk jetonë në Viti, por e njejtit jetonë në shtetin e Maqedonisë Veriut dhe se nuk i dihet adresa e saktë.

-Sipas përgjigjjes nga AKKVP, me nr.ref., me numër 01007/24hjq e dt.19.07.2024, gjykata është informuar se për ngastrat kontestuese, asnjë person, qoftë fizik apo juridik, nuk ka paraqitur asnjë kërkesë, ankesë apo çfarë do pretendimi tjetër pasuror- pronësor.

-Sipas kontratës së datës 12.12.1987, palë kontraktuese janë paraqitur, A.H. blerës dhe S. L. dhe S.D., lëndë e kontratës janë shitja e ngastrave kadastrale numer 00542-1, me sipërfaqe 3723 m² dhe ngastra kadastrale numer 00542-2 me sipërfaqe 3722 m², të gjitha në vendin “Jezva Bllatko” ZK Viti. Shuma e kontraktuar për të dy ngastrat ishte 3 milion dinar jugosllav, për të cilën është theksuar se të paditurat e kanë pranuar në ditën e nënshkrimit të kontratës, përveç palëve kontraktuese, dëshmitar i lidhjes së kontratës është shënuar R. M. dhe R.D..

-Nga deklarata e D.R.e dhene nën betim tek zyra e noterit A.S. në Viti, me numer LRP .nr. 8785/2024 e datës 07.11.2024., gjykata ka vërtetuar faktin se i njëjti kishte qenë prezent-dëshmitar në momentin e shitblerjes së palijtshmërve që janë objekt shqyrtimi, ku shitëset S.D. dhe S.L. si pronare-shitëse ia kanë shitur blersit A.H. nga fshati B., Komuna e Vitisë, me datën 12.12.1987 parcelen me numer P-00542-2, me sipërfaqe prej 3722m², dhe parcelen me numer P-00542-1, me sipërfaqe prej 3723m², ZK-Viti, në vendin e quajtur „Jezva Blato”, paditësi të njëjten palujtshmeritë i ka paguar në shumë prej 3 milion dinar jugosllav në atë kohë kur është arritur marrëveshja dhe shitëset e parcelave të larpërmenduar ja kanë dorëzuar në posedim dhe shfrytëzimin të menjëhershëm.

-Sipas përgjigjjes së Stacionit policor në Viti datës 10.10.2024, gjykata është informuar se të paditurat të paditurëve S.D. nuk jetonë në Viti, por e njejtit jetonë në shtetin e Serbisë dhe se nuk i dihet adresa e sakt, ndërsa e paditura S.L. nuk jetonë në Viti, por e njejtit jetonë në shtetin e Maqedonisë Veriut dhe se nuk i dihet adresa e sakt

-Sipas përgjigjes nga AKKVP, me nr.ref., me numër 01007/24hjq e dt.19.07.2024, gjykata është informuar se për ngastrat kontestuese, asnjë person, qoftë fizik apo juridik, nuk ka paraqitur asnjë kërkesë, ankesë apo çfarë do pretendimi tjetër pasuror- pronësor.

Gjendja faktike e vërtetuar

Nga administrimi i provave materiale dhe deklaratës së paditësit, gjykata ka vërtetuar se paditësit janë në posedim të papenguar të ngastrës kadastrale me **numër 0542-1**, në vendin e quajtur “Jezava Blato”, me sipërfaqe prej 3723m², ZK Viti, e evidentuar në emër të S.L.e cila kufizohet me në anën veriore me parcelën numër 351-0, me gjatësi 34.76m, në anën lindore kufizohet me parcelën numër 542-0 me gjatësi 108.47m, në anën jugore kufizohet me parcelen numer 541-0 me gjatësi 34.27m dhe në anën perendimore kufizohet me parcelën numër 3604-0, gjegjësisht me lumin “Morava e Binçës”, me gjatësi 108.56m, dhe të **ngastrës me numër 0542-2**, në vendin e quajtur “ Jezava Blato”, me sipërfaqe prej 3722m², ZK Viti, e evidentuar në emër të S.D., e cila kufizohet me në anën veriore me parcelën numër 351-0, me gjatësi 34.76m, në anën lindore kufizohet me parcelën numër 487-0, 492-0 dhe 493-0 me gjatësi 109.05m, në anën jugore kufizohet me parcelen numer 541-0 me gjatësi 35.55m dhe në anën perendimore kufizohet me parcelën numër 542-1, me gjatësi 108.47m

Paditësit, e kishin blerë ngastrën kadastrale me numër 0542-1 në vendin e quajtur “Jezava Blato”, me sipërfaqe prej 3723m² **ngastrës me numër 0542-2**, në vendin e quajtur “ Jezava Blato”, me sipërfaqe prej 3722m² ZK- Viti , qysh me datën 12.12.1987 nga të paditurat. Faktin krijimit të raportit juridik ndërmjet paditësve me të paditurat, gjykata e vërtetoi deklarat e paditësit A.H.dhe provata tjera materiale, kurse faktin e posedimit të pandërprerë gjykata e vërtetoi nga deklaratat e dëshmitarit A.H., të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor më datën 18.12.2024 si dhe nga deklarata e dëshmitarit D.R., e dhene nenbetim tek zyra e noterit A.S.në Viti, me numer LRP .nr. 8785/2024 e dates 07.11.2024.

Pas administrimit të provave dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, e duke u mbështetur në nenin 8 të LPK-së, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është bazuar, andaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Pasi gjykata e ka vërtetuar gjendjen faktike si më lart, si ligj material aplikoi Ligjin mbi Themelimin e Marrëdhënieve Juridike Pronësore të vitit 1980 (tutje LMTHJP), përkatësisht në nenin 28 të tij, sipas së cilit është përcaktuar: “Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh” ndërsa, neni 70 ka përcaktuar: “Posedimin e sendit e ka çdo person që ushtron drejtpërdrejt zotërimin faktik të sendit (posedimi i drejtpërdrejtë)” tutje, neni 72 ka përcaktuar: “Posedimi është i ligjshëm poqëse mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorimin e besimit. Posedimi është me mirëbesim poqëse mbajtësi nuk di ose nuk mund të dijë se sendi që e mban nuk është i tij. Mirëbesueshmëria e posedimit supozohet”.

Të gjitha provave materiale, gjykata ua fali besimin në tërësi pasi ishin në harmoni njëra-tjetrën, me të cilat u vërtetuan të gjitha pretendimet e paditësve rreth faktit të krijimit të raportit juridik me të paditurin, pagesës së çmimit të kontraktuar, posedimit të vazhdueshëm dhe të pandërprerë për më shumë se 30 vjet. Po ashtu, gjykata ua fali besimin deklaratave të dëshmitarëve të dëgjuar, Deklaratës së D.R.e dhene nën betim tek zyra e noterit A.S.ne Viti, me numer LRP .nr. 8785/2024 e datës 07.11.2024, pasi ishin në harmoni me njëra-tjetrën, me pretendimet si në padi dhe provat e tjera të administruara në këtë çështje kontestimore. Dëshmitarët, faktet lidhur me këtë çështje i kishin të njohura personalisht, pasi ishin dëshmitarë të kohës përkatësisht axha i paditësve dhe D.R., dëshmitar prezent kur ishte bërë pagaesa e këtyre blerjeve dhe i konfirmuan pretendimet e paditësve se ngastrat që janë objekt i kontestit, paditësit i kanë blerë, kanë hyrë në posedim dhe shfrytëzim për më shumë se 30 vjet të papenguar.

Vendimi për shpenzimet procedurale

Për shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u mbështetur në nenin 452.4 të LPK-së. shpenzimet e procedurës i bartin paditësit.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:250738, 18.12.2024
C.nr.920/2021**

**Gjyqtari,
Alush Sinani**

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.